



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.839/22

GJYKATA KOMERCIALE -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kuvendi i Republikës së Kosovës. me seli në Prishtinë, Rruga “Nëna Tereza”, p.n., të cilën e përfaqëson me autorizim Muhamet Bytyqi, Valon Dobruna dhe Argzon Mucaj, kundër të paditurës N.N.SH- B.I “E...”, me pronar H.S., me seli Komuna e Suharekës, Rruga “...”, nr...., për kompenzim dëmi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike .EK.nr.379/21 e datës 15/07/2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 31/08/2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET ankesa e paditëses Kuvendi i Republikës së Kosovës. me seli në Prishtinë, Rruga “Nëna Tereza”, p.n, **ANULOHET** Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.379/21 e datës 15/07/2018, dhe lënda i kthehet Gjykatës Komerciale Dhomës së Shkallës Parë parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar EK.nr.379/21 e datës 15/07/2018, në pikën I të dispozitivit ka vendosur të shpallet jo kompetente në çështjen juridike të paditëses Kuvendi i Republikës së Kosovës. me seli në Prishtinë, Rruga “Nëna Tereza”, p.n e ushtruar kundër të paditurës N.N.SH- B.I “E...”, me pronar H.S., me seli Komuna e Suharekës, Rruga “...”, nr...., ndërsa në pikën II është vendosur që pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda së bashku me të gjitha shkresat, në afat prej tri ditëve, t’i dërgohet në kompetencë lëndore Gjykatës së Themelore në Prizren-Dega Suharekë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i paditëses, me propozim që të aprovohet ankesa dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. E paditura nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se: Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja pranë gjykatës së shkallës së parë me datën 15/06/2021 ka paraqitur padi me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që t'ia paguaj dëmin material, duke e llogaritur edhe kamatën ligjore prej 8 %, duke filluar nga momenti i rënies në vonesë për përmbushje të kontratës e deri në përmbardimin e këtij aktgjykimi si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar është shpallur jo kompetente në çështjen juridike të kompenzimit të dëmit, duke u bazuar në nenin 17,19, 392 pika b) të LPK-së e lidhur me nenin 13 par.1.1 të Ligjit për Gjykatën , nenin 3 paragrafi 1 nën paragrafi 22 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare me Nr. 06/L-016 dhe dhe bazuar në nenin 16 paragrafi 1 nën paragrafi 1 i Ligjit për Gjykatat me Nr. 06/L – 054 duke konsideruar se nuk ka kompetencë lëndore të vendos këtë çështje juridike kontestimore, me arsyetim se paditësja nuk e ka satusin e Shoqërisë Tregtare i cili është kusht ligjor, për të qenë palë në procedurën që zhvillohet në këtë departament të kësaj gjykate, për këto arsye te dhëna më lartë, Departamenti për Çështje Ekonomike i kësaj gjykate, nuk ka kompetencë lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike kontestuese dhe mbi këtë bazë ka vendosur që lënda t'i kthehet në kompetencë lëndore të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega Suharekë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil.

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe si i tillë nuk mund të pranohet, pasi që aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të paraparë me nenin 182 par.1 të LPK-së.

Pretendimet ankimore të paditëses, konsistojnë në atë se palët me kontratë e kanë përcaktuar kompetencën territoriale të gjykatës, e gjykata e shkallës së parë nuk e ka pasur parasysh këtë fakt mirëpo lëndën ia dërgon në kompetencë lëndore Gjykatës Themelore në Prizren-Dega Suharekë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë vlerësoi edhe pretendimet lidhur me faktin se pala paditëse me datë 14.01.2021 ka paraqitur propozim për sigurim prove, andaj duke marr parasysh dispozitat e nenit 379 të LPK-së, Dhoma e Shkallës së Parë udhëzohet të veproj paraprakisht sipas këtij propozimi.

Dhoma e Shkallës së Dytë i shqyrtoj pretendimet ankimore të paditëses dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, për shkak se me neni 13 të Ligjit për Gjykatën Komerciale është përcaktuar kompetenca lëndore e Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Parë dhe Dhoma e Shkallës së Dytë si vijon: “Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: në kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre”.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka ardhur në përfundim se në këtë çështje juridike duhet të shpallët jo kompetente në pikëpamje lëndore, për shkak se nga referati i padisë rezulton se palët ndërgjyqëse janë shoqëri tregtare dhe me padi pretendohet se në mes tyre janë krijuar marrëdhënie juridiko-detyrimore me karakter afarist.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208, nenit 209, par.1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË- Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.839/22, data 31.08.2022

Kryetarja e kolegjit-Saranda Bogaj Sheremeti,

d.v